

Në bazë të nenit 14, paragrafi 1 dhe 3, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 167/2015 ), nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 27/14 dhe 199/14), dhe në lidhje me Mendimin e pranuar pozitiv për Planin vjetor për punësime gjatë vitit 2018 me nr. 12/6-2060/11 të datës 18.12.2017, NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup shpall:

**KONKURS PUBLIK nr. 02/2018**  
**për plotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të pacaktuar**  
**të angazhimit punues**

1. NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, ka nevojë për punësimin e:

Nr. rend.	Shifra	Emri i vendit të punës	Nr. i realizuesve
1	KDR.04.02.A 02.006	Roje të sigurisë – patrulla	2

2. Marrëdhënia e punës për të gjitha vendet e punës themelohet në kohë të pacaktuar të angazhimit punues.

3. Marrëdhënia e punës themelohet në orar të plotë të angazhimit punues.

4. Çdo kandidat duhet ti përmbush kushtet e përgjithshme:

- Të jetë nënshtrë i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të shfrytëzoi gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të jetë i moshës së pjekur;
- Të posedoj aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësorë të mos i jetë shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit.

5. Kandidatët që do të paraqiten duhet ti përmbushin kushtet e veçanta të parapara me LMP ose të Marrëveshjes kolektive për veprimtaritë komunale si dhe kushtet e përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, përkatësisht:

Kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe LMP ose me Marrëveshjen kolektive për veprimtaritë komunale për të gjithë personat ndihmës – teknik, përfshijnë:  
Kualifikimet profesionale:

- Persona ndihmës – teknik të nivelit të dytë (A2), me nivelin më të ulët të kualifikimit III, 180 kredi sipas ECVET ose arsim të mesëm tre vjeçar;
- Posedimi i licencës për sigurim dhe

Përvoja e punës, me sa vijon:

Për nivelin A2 së paku një vit të përvojës punuese në profesionin përkatës.

6. Orari i angazhimit punues është 40 orë gjatë javës (dhe angazhimi punues në ndërrime).

7. Neto paga themelore për vendin e punës Roje të sigurisë – patrulla është 18.375,00 denarë për orar të plotë pune,

8. Kandidatët për punësim, paraqiten në konkursin publik përmes fletëparaqitjes së plotësuar. Fletëparaqitjen për punësimin e kandidatëve, mund ta marrin në zyrat e ndërmarrjes publike ose në web faqen [www.parkovi.com.mk](http://www.parkovi.com.mk)

9. Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët për të gjitha vendet e punës duhet të dorëzojnë edhe:

- Biografi të shkurtër;
- Dëshmi për nivelin e përfunduar të arsimimit (origjinali i diplomës ose kopje e verifikuar te noteri);
- Vërtetim për posedimin e nënshtrësisë së Republikës së Maqedonisë (origjinali ose kopja e verifikuar te noteri);
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (origjinali ose kopja e verifikuar te noteri).

10. Fletëparaqitjet së bashku me shtojcat dorëzohen personalisht në ndërmarrjen publike ose përmes postës në adresën NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, rr. “Ilinden” nr. 104, 1000 Shkup. Kontakt telefoni: 02/3070 112 e-mail: [covecki.resursi@parkovi.mk.com](mailto:covecki.resursi@parkovi.mk.com)

Konkursi zgjat 5 ditë, duke llogaritur nga dita e shpalljes së fundit në shtypin ditorë.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë, fletëparaqitjet e plotësuara në mënyrë të parregullt, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

**NP “Parqe dhe gjelbërime”  
U.D. Drejtor**

-----  
**Ardijan Muça**